

URDHËR
Nr. 67, datë 23.1.2019

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 22, 25, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të neneve 5, 11, 22 dhe 23, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të ligjit nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 816, datë 7.10.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së shërbimit të jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, dhe të vendimit nr. 734, datë 9.9.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

I. Delegimin e kompetencave të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme zotit Gent Cakaj, me detyrë zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, për sa më poshtë:

1. Në fushën e zbatimit të ligjit nr. 23/2015 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”:

- a) ndjekjen e zbatimit të programit të qeverisë për politikën e jashtme;
- b) bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së strukturave të shërbimit të jashtëm dhe raportimin para Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- c) përfaqësimin e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, brenda dhe jashtë vendit, në rastet e pamundësisë së Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- ç) marrjen e masave organizative dhe mbikëqyrjen e proceseve administrative, në lidhje me:
 - i. emërimin e Komisionit të Karrierës Diplommatike;
 - ii. emërimin e nëpunësit në sistemin e karrierës diplomatike;
 - iii. dhënien e gradave diplomatike sipas propozimeve të Komisionit të Karrierës Diplommatike;
 - iv. dhënien e masave disiplinore, sipas propozimit të Komisionit të Karrierës Diplommatike;
 - v. punësimin e diplomatit të karrierës në organizata ndërkombëtare për periudha të përkohshme dhe në misionet diplomatike, dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë;
 - vi. ngritjen e komisionit të posaçëm për përzgjedhjen e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - vii. emërimin e ekspertëve jashtë shërbimit të jashtëm në misionet diplomatike dhe postet konsullore;
 - viii. emërimin/mbarimin e detyrës së diplomatëve në misione diplomatike/poste konsullore të Republikës së Shqipërisë;
 - ix. transferimin, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë të personelit të karrierës diplomatike, në bazë të propozimit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- d) mbikëqyrjen e veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplommatik;
- dh) dhënie mendimi Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme për miratimin e vizitave zyrtare dhe të punës së anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit;
- e) sugjerimin Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, të propozimit për emërimin dhe lirin e ambasadorit, të kreut të misionit diplomatik dhe konsullit të përgjithshëm.

2. Në fushën e zbatimit të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”:

a) dhënien e mendimeve për projekt marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore dhe çdo lloj mendimi tjetër institucional në lidhje me veprimtarinë me jashtë të institucioneve publike;

b) marrjen e masave organizative në lidhje me nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat lidhen në emër të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave, me autorizim të Presidentit, Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;

c) nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, të cilat lidhen në emër të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;

ç) kryesimin e delegacionit shtetëror përgjegjës për zhvillimin e dialogut politik dhe të negociatave me institucionet e Bashkimit Evropian.

3. Në lidhje me komunikimin me Këshillin e Ministrave, ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore:

a) marrjen e masave organizative për miratimin në sistemin *e-aktet* të projektakteve të iniciuara nga Kryeministri dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;

b) dhënien e mendimeve për projektaktet e paraqitura për mendim nga ministrinë, në formë shkresore;

c) komunikimin me ministrinë dhe institucionet qendrore për çështjet brenda fushës së kompetencës së Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

4. Marrjen e masave organizative, me qëllim monitorimin e menaxhimit financiar të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar.

5. Marrja e masave organizative me qëllim marrjen dijeni të informacionit të klasifikuar në përputhje me certifikatën e lëshuar nga DSIK-ja.

II. Z. Gent Cakaj, me detyrë zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

III. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
dhe MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Edi Rama